

Në bazë të nenit 62, dhe në lidhje me nenin 7 dhe nenin 38 të Ligjit për Kulturë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18 dhe 11/18), Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE

për grumbullimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2023, të dedikuara për financimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2023

I

Lëndë e thirrjes publike është financimi i programeve, projekteve dhe aktiviteteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2023.

II

Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë persona fizikë që banojnë në territorin e Qytetit të Shkupit (artistë dhe artistë të pavarur) të cilët kryejnë veprimtari nga fusha e kulturës në përputhje me Ligjin për Kulturë dhe dispozita të tjera pozitive ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë edhe personat juridikë që kryejnë veprimtari nga fusha e kulturës në territorin e Qytetit të Shkupit (institucione nga fusha e kulturës, shoqata civile, fondacione dhe institucione të tjera juridike, përveç institucioneve kombëtare), në përputhje me Ligjin për Kulturë dhe dispozitat e tjera pozitive ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

III

Thirrja publike ka të bëjë me financimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve në bazë të qëllimeve dhe kriterëve të përcaktuara për përzgjedhjen e projekteve kulturore me interes për Qytetin e Shkupit në këto fusha:

- 1.1. Arte performuese
- 1.2. Arte muzikore
- 1.3. Arte vizuale dhe arte të medimeve të reja
- 1.4. Veprimtari botuese dhe bibliotekare
- 1.5. Veprimtari muzeore dhe promovimi i trashëgimisë kulturore
- 1.6. Bashkëpunim ndërkombëtar

IV

Aplikuesit janë të obliguar të depozitojnë aplikimin për financimin e projekteve/programeve/aktiviteteve në përputhje me fushat e lartpërmendura dhe në përputhje me qëllimet dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit të dhëna si bashkëngjitje në këtë thirrje publike.

V

Aplikimet në formë të shkruar dhe të regjistruara në CD duhet të depozitohen në Qytetin e Shkupit, me postë në adresën: Bul. "Ilinden" nr.82, 1000 Shkup, ose në arkivin e Qytetit të Shkupit, jo më vonë se ora 15:00 e ditës së fundit të Konkursit (26.10.2022),

me shënimin: **Thirrje publike për grumbullimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2023, të dedikuara për financimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2023.**

Aplikimet mund të shkarkohen nga ueb-faqja zyrtare e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Të bashkëngjitur me aplikimin, aplikuesit janë të obliguar të sigurojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- dokument për veprimtari të regjistruar në territorin e qytetit të Shkupit të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2022 (jo më i vjetër se 6 muaj);
- vërtetim për xhiro llogari të hapur dhe aktive (jo më i vjetër se 6 muaj);
- dokumente të tjera, që lidhen me realizimin e aktivitetit (kontratat autoriale me pjesëmarrësit, hapësirë e siguruar ose partneritet me një institucion/organizatë, ftesë për pjesëmarrje në festival në vende të huaja, mjete financiare shitesë të siguruar, rekomandime, memorandum për bashkëpunim, etj.);

Në mënyrë plotësuese, duhet të depozitohet dëshmi nga fotokopja e kartës së identitetit të aplikuesit.

VI

Mjetet për financimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të aplikuesve janë parashikuar me Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2023.

VII

Thirrja publike zgjat 30 ditë kalendarike nga dita e publikimit në media dhe në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit. www.skopje.gov.mk, deri më 27.10.2022 më së voni deri në orën 15:00.

Vërejtje: Aplikimet në formë të shkruar me të dhëna të paplota dhe dokumentacion jo të plotë, aplikimet e plotësuar në formular joadekuat, si dhe ato që nuk janë depozituar brenda afatit të caktuar, nuk do të shqyrtohen.

Kryetarja e Qytetit të Shkupit do të sjellë Aktvendim për financimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2023, gjë me të cilën mjetet financiare do t'i alokojë sipas fushave dhe përfituesve.

Aktvendimi për financimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2023 do të shpallet në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit. www.skopje.gov.mk.

Informacione plotësuese mund të merren në numrat e telefonit: 02/3297-289, 02/3297-243 dhe në adresën e-mail: kultura@skopje.gov.mk.

**Kryetarja e Qytetit të Shkupit
Danela Arsovska**